



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TE EKONOMISË

Nr. 2 Prot

Datë, 25.03.2020

VENDIM

Nr. 2, datë 25.03.2020

PËR

PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E EKONOMISË NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI” VLORË.

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të nenit 7 pika 6/d, nenit 18, pika 3 të Vendimit të Senatit Akademik Nr.59, datë 11.02.2020 “Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë; Vendimit Nr.1, datë 20. 03. 2020 “Për Shpalljen e fituesit të Kryetarit të Komisionit Zgjedhor pranë Fakultetit të Ekonomisë (KZFE):

Komisioni Zgjedhor i Fakultetit:

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në Njesisë Kryesore në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve nga data 28.03.2020 deri në datën 01.04.2020, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit për të depozituar dokumentacionin për kandidim. Pas regjistrimit, kandidatit i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit.
4. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë dhe në faqen zyrtare www.univlora.edu.al
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Grigor Dede (Kryetar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit)

Ilira Pulaj (Anëtare)

Desantila Ahmeti (Anëtare/studente)

Briseida Ramaj (Sekretare)